

P.nr.890/11

**NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Artan Sejrani, me sekretaren juridike Florije Kolukaj si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. G. nga fshati A. – Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të shantazhit nga neni 268 par.1 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Komunale në Prizren, PP.nr.2212/11 e datës 15.06.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. S. M. nga Prizreni, me datë 03.12.2014, publikisht mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M****I akuzuari:**

**F. G.**, me nofkën “J.”, nga i ati Xh. dhe e ëma R., e lindur K., data e lindjes ... në Prizren, tani me vendbanim në fshatin A., Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se prej muajit mars deri me datën 08.06.2011, në Prizren, me qëllim që vetes ti sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, e kanos të dëmtuarën Sh. H., se do të zbulojë diç që do ta dëmtojë nderin dhe autoritetin e saj dhe me këtë e detyron të veprojë në dëm të pasurisë së saj dhe familjes, në atë mënyrë që vazhdimisht kërkon nga e dëmtuara që ti sjellë të holla, ari dhe gjësende tjera, duke kanosur “ që nuk mi sjellë të hollat do të vij te babai yt dhe do ti tregojë për lidhjen tonë si dhe do të bëjë montime të ndryshme dhe ti qes në internet”, me ç’rast e dëmtuara nën kërcënimin e vazhdueshëm, merr nga shtëpia e saj 2000 €, 3 lira, disa hallka dore, 1 unazë, disa zinxhirë dhe disa palë vath të arit, të cilat kohë pas kohe ia jep të akuzuarit.

- **Kesodore ka kryer veprën penale të shantazhit nga neni 268 par.1 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34, 36, 38, 64, nenit 268 parag.1 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin e:

**G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

E dëmtuara Sh. H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësorë të paguajë në shumën prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.2212/11 e datës 15.06.2011, kundër të akuzuarit F. G. nga fshati A. – Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të shantazhit nga neni 268 par.1 të KPK. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, sepse i akuzuari F. G. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë e cila u vërtetua edhe në shqyrtimin gjyqësor nga deklarata e të dëmtuarës Sh. H., deklarata e dëshmitarit M. B. si dhe nga deklarata e nënës së të dëmtuarës Xh. H., gjithashtu vërtetohet pjesërisht edhe nga deklarata e të pandehurit i cili pranon se nga Shqipja kishte marrë para dhe ari mirëpo mohon faktin që i njëjti ta ketë detyruar apo shantazhuar për dhënien e këtyre gjësendeve – të hollave. Duke pasur parasysh faktin që e dëmtuara Sh. H. në atë kohë ka qenë e mitur apo relativisht e re shtrohet pyetja si e dëmtuara e posedoj shumën e të hollave dhe arit të cilat ia ka dhënë të akuzuarit. Andaj në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale duke propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit. Gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duhet të merr parasysh të gjitha rrethanat si ato rënduese dhe ato lehtësuese.

E dëmtuara Sh. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështetë në tërësi fjalën e Prokurores së Shtetit dhe ka parashtruar kërkesë pronësore – juridike në shumë deri në 10.000 euro në emër të arit dhe të hollave.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. G. av. S. M. në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar se konsideron se me provat e nxjerrura gjatë shqyrtimeve kryesore nuk është provuar se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Për të ekzistuar kjo vepër penale duhet të plotësohen elementet qenësore se i akuzuari me veprime konkrete të ketë shantazhuar të dëmtuarën si personalisht fizikisht, moralisht apo në mënyra tjera me mjete elektronike, e këtu nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij të ketë bërë këtë dhe nuk ka zbuluar asgjë që e zbulon nderin dhe autoritetin e saj, nuk ka bërë kurrfarë montimi nëpërmjet internetit apo mjeteve tjera elektronike që të detyroj në ndonjë mënyrë të dëmtuarën që ajo të veprojë në dëm të pasurisë së saj. E dëmtuara ka jetuar në bashkësi familjare me prindërit e saj të cilët e kanë pasur në mbikëqyre të njëjtën. Me të akuzuarin sipas aktakuzës del që ka kaluar prej muajit mars gjer në muajin qershor 2011 gjatë kësaj kohe e njëjta ishte e kërcënuar dhe e shantazhuar siç përshkruhet në aktakuzë, e njëjta ka pasur mundësi të lajmëroë familjen e saj respektivisht, prindërit dhe njëkohësisht policinë dhe lidhja e tyre ka qenë me dëshirë pa kurrfarë kërcënime apo mashtrimi, të hollat dhe gjësendet tjera të cilat janë cekur nga ana e dëmtuarës e njëjta i ka dhënë me vetë dëshirë dhe të njëjtat janë kthyer nga ana e të akuzuarit, po që se pala e dëmtuar është e dëmtuar për këtë duhet argumentuar me prova konkrete e në këtë çështje penale përveç deklaratave të dyjave palëve, prova tjera materiale nuk ka se i akuzuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që kishte me u evidentuar apo inçizuar përkitazi me shantazhet e bëra ndaj të dëmtuarës, andaj në mungesë të provave, propozon gjykatës që të akuzuarin ta liron nga akuza.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësorë ka nxjerrë të gjitha provat e propozuara dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe në tërësi ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I akuzuari F. G. dhe e dëmtuara Sh. H. janë njoftuar në vitin 2010, në fillim kanë pasur raporte shoqërore, më vonë kanë pasur lidhje dashurie me njëri – tjetrin e cila ka zgjatur rreth 4 muaj dhe pastaj janë ndarë. E dëmtuara ka jetuar së bashku me prindërit e saj dhe motrën. Pas ndarjes i akuzuari vazhdimisht prej muajit mars deri me datën 08.06.2011 e ka penguar duke e thirrur në telefon dhe nëpërmjet mesazheve, të cilën e ka kërcënuar dhe shantazhuar, ku nga e dëmtuara vazhdimisht ka kërkuar që e njëjta ti sjell të holla, ari dhe gjësende tjera me vlerë dhe nëse e njëjta nuk ia sjellë të hollat i akuzuari e ka kërcënuar se nëse nuk ia sjellë të hollat që i ka kërkuar do të shkon tek babai i saj dhe do ti tregon lidhur me lidhjen që kanë pasur dhe do ti bënë montime të ndryshme të cilat do ti qes në internet. E dëmtuara nën kërcënimin e vazhdueshëm nga ana e të akuzuarit dhe nga frika prej familjes, të njëjtit vazhdimisht i sjellë të holla, ari dhe gjësende me vlerë. E dëmtuara herën e parë nga frika dhe nën presionin e të akuzuarit ia sjell të akuzuarit një zinxhir. Pas një periudhe i akuzuari sërish nëpërmjet telefonit kërkon nga e dëmtuara të holla se i nevojiten se do të shkon në Slloveni dhe nëse ia sjellë më nuk do ta pengojë, në të kundërtën do të shkon tek shtëpia e saj dhe do ti tregon babait të dëmtuarës çdo gjë dhe e dëmtuara nga frika prej familjes dhe veçanërisht prej babait të saj ia sjell shumën prej 2000 euro të cilat i merr prej familjes pa lejen e tyre, të cilët në fillim nuk e kanë hetuar. I akuzuari sërish kërkon nga e dëmtuara të holla duke kërkuar para e cila sërish të akuzuarit ia jep edhe 300 euro, i cili pas një kohe sërish vjen edhe takohet me të dëmtuarën afër shtëpisë së saj i cili ishte me një motor e cila nga frika e familjes del nga shtëpia dhe takohet me të akuzuarin, të cilin me të vërejtur nëna e të dëmtuarës largohet nga vendi i ngjarjes dhe e dëmtuara nga presioni dhe kërcënimi i vazhdueshëm nga ana e të akuzuarit, i tregon nënës së saj për kërcënimet dhe shantazhimet që është duke i bërë i akuzuari të cilit ia ka dhënë të hollat, ari dhe gjësendet tjera me vlerë dhe më pastaj së bashku me prindin e saj përkatësisht babain e saj e lajmërojnë rastin në Polici.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar pjesërisht në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit, deklaratave të dëshmitarëve Sh. H., M. B. dhe Xh. H.

I akuzuari F. G. duke mohuar kryerjen e veprës penale ka deklaruar se me të dëmtuarën Sh. është njoftuar para 7 – 8 muajve në vitin 2011 në rrugë, me të cilën kanë filluar të bisedon me të nëpërmjet internetit në facebook, me të cilën në fillim kanë pasur raporte shoqërore dhe gjatë kohës që janë takuar kanë pasur raporte të mira por përkundër që e dëmtuara ka qenë vajzë e mirë nuk ka pasur mendime serioze, por në të njëjtën kohë nuk ka pasur qëllim që ta shfrytëzon. Pastaj kanë filluar lidhje dashurie e cila ka zgjatur 3-4 muaj. Para dy – tre muajve ka qenë në gjendje pak të vështirë ekonomike edhe pse kjo nënkupton që nuk ka pasur të holla të mjaftueshme për të dal në qytet dhe për këtë kanë biseduar me të dëmtuarën e cila me dëshirën e saj ia ka sjellë 300 euro, dy lira, një hallkë dore, një unazë, dhe një qafore të cilën e ka pyetur ku i ka marrë të hollat e njëjta i është përgjigjur se janë të sajat, të cilat me datë 08.06.2011 ia ka kthyer Sh. me të cilën janë takuar para gjimnazit. Po ashtu Sh. mi ka dhënë edhe 150 euro për ditëlindje të cilat kanë qenë të mbështjellura me një zarf. Po ashtu kur kanë dal në qytet me të dëmtuarën, kanë bërë muhabet për shkollë, për shoqëri dhe i ka thënë se nuk ka veturë personale dhe udhëton nga fshati në qytet dhe ajo në atë rast i ka dhënë edhe 70 euro. I akuzuari mes tjerash ka deklaruar se asnjëherë nuk ka kërkuar prej Sh. që ajo të sjellë para, ari ose

gjësende tjera me vlerë dhe nuk e ka detyruar apo kërcënuar se do të shkon në familjen e saj përkatësisht tek babai i saj që ti thotë se ka pasur marrëdhënie intime me të apo do ti monton diçka që tia qes në internet dhe nëse do të kishte për qëllim të keq ndaj saj ka pasur mundësi që ta shfrytëzon dhe ta keqpërdorë në ndonjë mënyrë tjetër, meqenëse ka qenë në lidhje dashurie me atë. Po ashtu ka deklaruar se nuk ka kërkuar prej të dëmtuarës që ti tregon familjës lidhur me lidhjen që kanë pasur dhe se me të njëjtën janë ndarë pas 4 ose 5 muajve, por edhe përkundër ndarjes kanë pasur raporte shoqërore dhe Sh. vazhdimisht nuk ka hekur dorë prej tij, ndërsa lidhja nuk ka vazhduar. Po ashtu ka shtuar se në kohën kur ia ka dhënë parat dhe dukatin nuk ka qenë në lidhje me Sh.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit dhe besueshmërinë e deklaratës së tij duke bërë krahasim me faktet të tjera dhe të njëjtën ka pranuar në atë pjesë se nuk është kontestuese se me të dëmtuarën Sh. H. kanë qenë në lidhje dashurie e cila lidhje ka zgjatur shkurt përafërsisht 3 – 4 muaj dhe më pas është ndarë dhe pas ndarjes me të njëjtën ka biseduar nëpërmjet mesazheve dhe nga e dëmtuara ka marrë 300 euro, dy lira, një hallkë dore, një unazë, dhe një qafore. Të gjitha këto fakte gjykata ka vërtetuar në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit, deklaratës së të dëmtuarës, i cili në mes tjerash ka deklaruar lidhje dashurie e cila ka zgjatur 3-4 muaj. Para dy – tre muajve ka qenë në gjendje pak të vështirë ekonomike edhe pse kjo nënkupton që nuk ka pasur të holla të mjaftueshme për të dal në qytet dhe për këtë kanë biseduar me të dëmtuarën e cila me dëshirën e saj ia ka sjellë 300 euro, dy lira, një hallkë dore, një unazë. Po ashtu Sh. mi ka dhënë edhe 150 euro për ditëlindje të cilat kanë qenë të mbështjellura me një zarf. Po ashtu kur kanë dal në qytet me të dëmtuarën, kanë bërë muhabet për shkollë, për shoqëri dhe i ka thënë se nuk ka veturë personale dhe udhëton nga fshati në qytet dhe ajo në atë rast i ka dhënë edhe 70 euro. Në këtë drejtim kanë dëshmuar edhe dëshmitarët Sh. H., M. B. dhe Xh. H., deklaratat e të cilëve përputhen sa u përket fakteve të cekura më lartë, prandaj edhe gjykata u ka falur besim.

Gjykata ndërkaq nuk i ka besuar mbrojtjes së të akuzuarit në atë drejtim se nuk ka kërkuar prej Sh. që ajo të sjellë para, ari ose gjësende tjera me vlerë dhe nuk e ka detyruar apo kërcënuar se do të shkon në familjen e saj përkatësisht tek babai i saj që ti thotë se ka pasur marrëdhënie intime me të apo do ti monton diçka që tia qes në internet dhe nëse do të kishte për qëllim të keq ndaj saj ka pasur mundësi që ta shfrytëzon dhe ta keqpërdorë në ndonjë mënyrë tjetër, meqenëse ka qenë në lidhje dashurie me atë etj. Kjo sepse mbrojtja e tij është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve nëse merret parasysh tërë zhvillimi i ngjarjes, gjykata ka dëgjuar të dëmtuarën Sh. G. në cilësi të dëshmitares e cila mes tjerash ka deklaruar se nga muaji mars i vitit 2011 deri ne qershor të vitit 2011 vazhdimisht ka pasur presion prej të akuzuarit F. G., i cili ka kërkuar gjësende, dukatë, para, kinse do ti tregoj familjes së saj që me të akuzuarin ka pasur lidhje intime, ku e dëmtuara prej frikës nga familja nuk i ka treguar se ka qenë në lidhje me të akuzuarin dhe duke menduar se i njëjti nuk do të pengon më dhe do të largohet të njëjtit i ka dhënë para në fillim 2000 euro, më pastaj ia ka dhënë edhe 300 euro si dhe gjësende të ndryshme si ari, hallka, zinxhir, unaza dhe gjësende të vogla që lidhur me këto më vonë i ka treguar familjes dhe M. B. i cili është i fejuari i saj. Po ashtu edhe dëshmitari M. B. ka dëshmuar i cili ka deklaruar se i ka treguar Sh. se një person e thirre vazhdimisht në telefon dhe i kërkon të holla dhe nga Sh. ka kërkuar numrin e telefonit të këtij personi dhe me të cilin ka kontaktuar dhe të njëjtit i ka thënë qe mos ta thirre, mos ta pengoj, i cili i ka thënë që Sh. ta hap vetëm edhe një herë telefonin por dëshmitari i ka thënë që mos ta pengoj më, por i njëjti ka vazhduar që ta

thirre, derisa ia ka ndërruar edhe numrin e telefonit të dëmtuarës. Edhe dëshmitarja Xh. H. e cila ka dëshmuar dhe ka deklaruar se ka fundi i marsit të vitit 2011, në shtëpi kanë humbur gjësende – dukat, të holla, që në fillim nuk kanë pasur dyshime të askush, ndërsa ka fundi i prillit dhe në fillim të majit 2011, vajza Sh. H. kishte probleme me lukth dhe ka menduar se ka nga mësimi, mirëpo javën e fundit e ka vërejtur se folte në telefon shpeshë, që në fillim nuk ka dyshuar asgjë por më vonë e përcjellë gjendjen e saj dhe një ditë e njëjta nuk kishte shkuar në shkollë ka qenë në shtëpi, të cilën nuk e ka lejuar që të dilte jashtë shtëpisë dhe në një moment vajza ka dalur nga shtëpia dhe me të vërejtur se ka dal, e njëjta ka dal jashtë që ta përcjellë dhe me të kthyer nga rruga e ka parë vajzën e cila ishte së bashku me një djalë i cili ishte me motor dhe i njëjti me të vërejt të ëmën e të dëmtuarës menjëherë është larguar nga vendi ndërsa e dëmtuara me të vërejtur të ëmën është shqetësuar - saritur, ka filluar të qaj dhe te dridhet dhe nën një automjet i cili ishte i parkuar aty pranë lëshon diqka nga dora dhe të cilën e ka pyet se çka kishte e njëjta nuk ka guxuar në fillim ti tregon prej frikës nga ana e babait, mirëpo dëshmitarja Xh. me të marë nga toka kesën - sendin që e kishte lëshuar e demtuara dhe me të vërejtur se aty ishin një tasfes i arit dhe një kollan, atëher i drejtohet të dëmtuarës se ti i paske marë të gjitha të hollat dhe arrin, e demtuara i tregon të ëmës Xh. se me të akuzuarin ka pasur lidhje dashurie mirëpo me të njëjtin janë ndarë, por i njëjti vazhdimisht e ka kërcënuar, e dëmtuara i ka treguar të ëmës se ka marrë shuma të ndryshme të të hollave, ka mare ari, zinxhir, kollan, unazë, më pastaj dëshmitarja ka filluar që ta qetsojë të demtuarën e ka futur brenda në shtëpi i ka dhanë një qetësues dhe e ka njoftuar se duhet ta therasim babain dhe ti tregojm, por duke shkuar dëshmitarja për të marë një gotë ujë e demtuara tenton që të kërcejë nga ballkoni i katit të tret. Pastaj ka ardhë bashkëshorti i dëshmitarës është njoftuar me të gjithë rastin nga dëshmitarja dhe rasti është paraqitur në polici.

Gjykata ka besuar deklaratave të këtyre dëshmitarëve sepse janë të qarta, të besueshme, në përputhje me njëra-tjetrën, dhe pjesërisht edhe me mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë pranë Prokurorisë dhe në shqyrtimin gjyqësorë të cilën deklarata përputhen njëra me tjetrën sepse veti i akuzuari ka pranuar se ka pasur kontakte me të dëmtuarën dhe e ka thirrur të njëjtën dhe nga e dëmtura ka pranuar shumën e të hollave 300 euro, hallkë, zinxhir, unazë etj dhe se mbrojtja e të akuzuarit është në kundërshtim me vetveten dhe me provat e cekura më lartë. Ndërsa gjykata nuk ia ka falur besimin dëshmitarit A. R. sepse dëshmitari është mik përkatësisht shok i të akuzuarit dhe dëshmija e tij është e njënashme dhe ka pasur për qëllim shmangien e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata duke i pasur parasysh të gjitha faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit F. G. e më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të shantazhit nga neni 268 par.1 të KPK. Kjo nga se i akuzuari nëpërmjet telefonit dhe mesazheve, i është kërcënuar të dëmtuarës, se nëse nuk ia sjellë të hollat 2000 euro, 300 euro si dhe gjësendet tjera me vlerë si dukat, ari, unazë, hallkë, zinxhir etj, do ta zbulojë lidhjen e tyre si dhe që kanë pasur marrëdhënie intime me të, gjë që e detyron të dëmtuarën që të akuzuarit të i jep të hollat dhe gjësendet e cekura si më lartë, ngase i akuzuari me fakte të pavërteta të cekura më lartë, se do të dëmtojë nderin dhe autoritetin e saj, me qëllim të realizimit të dobisë pasurore të kundërligjshme.

Nga të gjithë të cekurat më lartë gjykata ka ardhur deri te konkluzioni se në veprimet e të akuzuarit formohen te gjitha elementet e kësaj vepre penale, për të cilën e ka shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Gjatë marrjës së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitës së nenit 64 të KPK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit, si rrethanë rënduese në veprimet e të akuzuarit ka gjetur peshën e veprës penale, dashjen direkte, mënyren e kryerjës së veprës penale, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari gjerë më tani nuk ka qenë i gjykuar, është i moshës së re, ka pasur sjellje korrekte para gjykatës dhe për këte gjykata ia shqiptoi dënimn me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, me bindje se ky dënim i tillë i shqiptuar te i akuzuari do të ndikojë pozitivisht, dhe se i njejt i përgjigjet intenzitetit dhe shkallës së përgjegjesisë penale juridike, dhe se ky dënim i shqiptuar është në proporcion me veprën penale të kryer dhe në rrethanat personale të cilët i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Vendimi mbi kërkesën pronësore-juridike është marrë në bazë të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.890/11, Me datë 03.12.2014**

**Procesmbajtësja**  
**Florije Kolukaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Artan Sejrani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – e nëpërmjet të kësaj gjykate.